




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.30, datë 23.12.2024



**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SUBJEKTI “ÇAUSHI ENERGJI” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik subjekti “Çaushi Energji”, nëpërmjet HEC “Qafëzezë” në përroin e Shtikë, Kozelit dhe Gjançit, rrethi Kolonjë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Qafëzezë

Vendndodhja e veprës së marrjes 1 burimi ujqor Përroit Shtikës

- X= 556363.024; Y= 4479480.549; Z=890.9 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.42 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.37 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.018 m³/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 2 burimi ujqor Përroit Kozelit

- X= 555964.231; Y= 4480380.614; Z=888.87 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.35 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.28 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.014 m³/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 3 burimi ujqor Përroit Gjançit

- $X=555357.581$; $Y=4480844.835$; $Z=884.8$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: $0.43 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore: $0.37 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike: $0.018 \text{ m}^3/\text{s}$

Vendndodhja e veprës së marrjes 4 burimi ujqor Lumi i Elmicës

- $X=553446.986$; $Y=4480042.662$; $Z=883.5$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: $0.5 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore: $0.42 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike: $0.02 \text{ m}^3/\text{s}$

Vendndodhja e godinës së Centralit

- $X=553765.108$; $Y=4478271.657$; $Z=838$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: $1.7 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 5,350,000 kWh/vit
- Fuqia e instaluar: 1450 kwh

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

ARBEN ÇUKO

